

VENDIM
Nr. 299, datë 19.10.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “TRUEN” SHPK, PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON
INTERESAT E SAJ**

(ndryshuar me vendimin nr. 7, datë 22.1.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 5, 7 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1959/9 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Truen’ sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Truen” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 13, datë 30.1.2013, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 12, datë 30.1.2013.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1959 prot., datë 24.7.2023 dhe nr. 1959/1 prot., datë 3.8.2023, shoqëria ka paraqitur aplikimin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51% të kuotave të zotëruara nga ortaku i shoqërisë “CN’AIR” tek ortaku tjetër i shoqërisë “Ylliad”, i cili zotëron 49% të kuotave dhe me këtë transferim bëhet ortak me 100% të kuotave.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1959/2 prot., datë 16.8.2023, iu evidentua shoqërisë dhe dokumentacioni i munguar për këtë aplikim. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1959/3 prot., datë 28.8.2023, ka kërkuar nga ERE më shumë më kohë në dispozicion për plotësimin e këtij dokumentacioni, ndërsa me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1959/5 prot., datë 12.9.2023, nr. 1959/7 prot., datë 28.9.2023 dhe nr. 1959/8 prot., datë 6.10.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1 (germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”) dhe pika 2 (germat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “e” dhe “f”) të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.

- Brenda datës 31.12.2023, shoqëria “Truen” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE miratimin me shkrim të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., për lirimin pa asnjë rezervë dhe asnjë kusht të kuotave të saj.

- Shoqëria “Truen” sh.p.k nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa u përket pagesave të rregullimit.

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Truen” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Truen” sh.p.k.

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë “Truen” sh.p.k. bëhet “Ylliad” sh.p.k.

3. *Shfuqizuar*

4. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Truen” sh.p.k. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

5. *Shfuqizuar*

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Truen” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti